



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs



Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police
Drejtorja e Përgjithshme e Policisë/
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Titulli:	Strategjia dhe Plani i Veprimit 2017-2021 Policimi në Bashkësi
Data:	20. 12. 2016.
Numri:	

Me anë të kësaj shkrese aprovoj Strategjinë dhe Planin e Veprimit 2017-2021 “Policimi në Bashkësi”, e cili hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.



Rej Z. Shpend Maxhuni
Drejtore i Përgjithshëm i Policisë

(nënshkrimi)



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate



STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT

2017-2021

“POLICIMI NË BASHKËSI”

PËRMBAJTJA

Përmbajtja	2
Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës	3
Përmbledhje Ekzekutive	5
Hyrje	6
Metodologjia	8
Korniza Ligjore	10
Gjendja aktuale dhe perspektiva.....	11
Vizioni, Misioni dhe Parimet e Strategjisë	13
Vizioni, misioni dhe parimet e strategjisë së policimit në bashkësi.....	17
Fushat e vlerësimit rreth të arriturve të strategjisë së Policimit në Bashkësi	19
Shkurtesat	21
Përkufizimet	22
Plani i veprimit.....	24

MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË POLICISË SË KOSOVËS

Siguria është një nga aspektet primare të shoqërisë njerëzore që e ka përcjellë njeriun në të gjitha fazat e zhvillimit.

Të jetuarit dhe të vepruarit e lirë dhe pa frikë, është me interes parësor të çdo qytetari, pa dallim moshe, gjinie, race apo përkatësie fetare, prandaj çdo cënim i sigurisë edhe në vendin tonë dëmton rëndë principet bazë të të drejtave dhe lirisë së çdo qytetari.

Vizioni i Policisë së Kosovës, veprimtarinë e vet policore e orienton drejt ofrimit të sigurisë, zbatimit të ligjit dhe parandalimit të krimit, gjithnjë me përkushtim në shërbim të qytetarëve për të promovuar ambient të qetë dhe të sigurt.

Vazhdimi i implementimit të Strategjisë së Policimit në Bashkësi dhe Plani i Veprimit për periudhën kohore 2017-2021, në vet-vete ka përqafuar moton kryesore “Policia është populli dhe populli është policia” e që në fokus ka zhvillimin dhe avancimin e partneritetit me qytetarin.

Kjo strategji synon zhvillimin dhe avancimin e konceptit “policimi i orientuar në bashkësi”, si pjesë e filozofisë policore, tashmë e praktikuar edhe te ne.

Për realizimin në praktikë të kësaj strategjie kemi vendosur katër objektiva kryesore që përfshijnë: fuqizimin dhe avancimin e partneritetit, ngritjen e besueshmërisë dhe kënaqshmërisë së publikut me punën policore, bashkëpunimin e aktiviteteve të policimit në bashkësi me strategjitë tjera dhe avancimin e reformave të brendshme dhe mekanizmat për monitorimin e zbatimit të strategjisë.

Përmes ofrimit të shërbimeve profesionale, efektive, efikase dhe duke demonstruar sinqeritet, ndershmëri, transparence dhe llogaridhënie do të përmbushim pjesë të misionit tonë duke avancuar ngritjen e “Besueshmërisë dhe kënaqshmërisë” karshi publikut.

Promovimi dhe avancimi i Partneritetit të Policisë së Kosovës me qytetarët, do të avancohet duke përdorur forma dhe metoda të ndryshme bashkëpunuese që do të na ndihmojnë në caktimin e prioritetëve policore, fillimisht në identifikimin e shkaktarëve potencial të kriminalitetit dhe në ofrimin e zgjidhjes së problemeve përbrenda shoqërisë.

Ky partneritet është një faktor i fuqizimit të krijimit të nevojës dhe të ndjenjës së përgjegjësisë të përbashkët me shoqërinë për adresimin dhe zgjidhjen e çështjeve të identifikuara problematike dhe shqetësuese.

Me aplikimin e këtij koncepti të veprimit nga Policia e Kosovës, qytetarët e Republikës së Kosovës jo vetëm që do të jetojnë pa frikë nga krimi por edhe do të kontribuojnë në luftën kundër kriminalitetit dhe parandalimin e dukurive negative në shoqëri.

Një ambient i sigurtë është vendimtar për emancipim shoqëror, mirëqenie dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Strategjia e Policimit në Bashkësi 2017-2021 reflekton zotimin e Policisë së Kosovës dhe përkushtimin e saj në ngritjen e sigurisë në bashkësi me anë të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve me gjithë aktet të cilët mbulojnë fushën e sigurisë në bashkësi, dhe që në mënyrë preventive veprojnë në identifikimin dhe zgjedhjen e problemeve të cilat shkaktojnë shqetësimin dhe frikën e qytetarëve.

Kjo është më se e domosdoshme pasi që ndërtimi i besimit, forcimi i legjitimitetit, ngritja e bashkëpunimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve ndërmjet të gjithë akterëve të cilat mbulojnë fushën e sigurisë në bashkësi, është çelësi për stabilitetin e bashkësive, integritetin e sistemit tonë të drejtësisë penale, dhe ofrimin efektiv dhe efikas të shërbimeve policore.

Për këtë arsye, Policia e Kosovës ka dhënë një theks të veçantë në këtë strategji, për rritjen e ndërveprimit me bashkësinë nëpërmjet Këshillit të Komunal për Siguri në Bashkësi në kuadër të komunës, Komitetit për Lokal për Siguri Publike, komunitet e biznesit, komunitetet kulturore-sportive, OJQ-ve dhe institucioneve të arsimit para-universitarë. Shumëllojshmëria e përfaqësuesve të këtyre bashkësive, në theks veçantë të aspekti gjinor, etnik, religjioz, kulturor dhe provoja jetësore, janë një ndër pasuritë më të rëndësishme për policim të qëndrueshëm në bashkësi. Gjithashtu me këtë strategji është paraparë që ndërveprimi me bashkësinë të shoqërohet me hulumtimin e opinionit publik, si një mjet për matjen e nivelit të besueshmërisë ndaj policisë.

Në mënyrë që policia të jetë efikase dhe efektive në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësisë të saj të policimit në bashkësi, është shumë me rëndësi të madhe që ato të zhvillohen në përputhje me politikat e përcaktuara, të cilat duhet të pasqyrojnë vlerat e bashkësisë, si dhe sfidat e brendshme dhe të jashtme policore. Për këtë arsye, kjo strategji është përqendruar në avancimin e reformave të brendshme të policisë, si dhe në forcimin e mbikëqyrjes së brendshme dhe të jashtme të policimit në bashkësi në Kosovë.

Në kuadër të avancimit të reformave të brendshme të policisë, një fokus i veçantë i është dhënë edhe organizimit të trajnimeve të ndryshme për shkak të gamës së gjerë të sfidave të reja të policimit. Këto trajnime janë të detyrueshme pasi që, zyrtarët policorë duhet të jenë të trajnuar dhe të aftë për të trajtuar një shumëllojshmëri të gjerë të sfidave, duke përfshirë terrorizmin ndërkombëtar, teknologjitë në zhvillim të vazhdueshëm, rritje e emigracionit, ndryshimet në legjislacion, normat të reja kulturore, si dhe sfidat e tjera.

Avancimi i teknologjisë dhe përmirësimi i përdorimit të rrjeteve sociale të komunikimit është gjithashtu në fokus të kësaj strategjie, pasi që përdorimi i tyre mund të përmirësojë praktikën e policimit dhe njëkohësisht të ndikojë në ndërtimin e besimit të bashkësisë dhe forcimin e legjitimitetit. Zbatimi i teknologjive të reja i ofrojnë policisë një mundësi për të angazhuar dhe

ngritur vetëdijsimin e bashkësive për një dialog mbi pritjet e tyre lidhur me transparencën, llogaridhënien dhe privatësinë.

Zbatimi i kësaj Strategjie bazohet në katër (4) hapa kryesorë si në vijim:

- *Plani i veprimit*, me gjithsej 4 objektiva strategjike, 12 nën-objektiva strategjike, 55 aktiviteteve, të cilat konkretizojnë masat dhe veprimet të cilat duhet të ndërmerren për të përmbushur misionin dhe vizionin e kësaj strategjie, përcjell me trupat koordinues dhe subjektet e definuara si institucione për zbatimin e tyre, afatet kohore dhe burimet materiale të nevojshme për zbatim, si dhe indikatorët e monitorimit të zbatimit.
- *Caktimi i burimeve njerëzore*-
- *Financimi i aktiviteteve*, të cilat janë definuar në bazë të vlerësimit të përafërt të burimeve financiare në dispozicion nga buxheti i Policisë së Kosovës, i cili mbetet burimi kryesor i financimit të aktiviteteve të policimit në bashkësi
- *Mekanizmi për Monitorim të Zbatimit të Strategjisë* – Emërimi i koordinatorit dhe grupit për zbatim dhe monitorim në nivel qendror të DPP-së dhe në nivel rajonal të rendit dhe kufirit, organizimet e takimeve vlerësuese periodike, inspektimet në terren për zbatim të strategjisë,

HYRJE

Zhvillimi i trendit të krimit, dinamika e qarkullimit të njerëzve dhe mallrave, avancimi i shpejtë i teknologjisë, vështirësitë e paraqitura në të kaluarën në aspektin e sigurisë në bashkësi si dhe synimet tona drejt euro-integrimeve ka sjellë deri tek një kërkesë e qytetarëve, por edhe të vetë Policisë që të avancohet partneriteti i sinqertë në mes të qytetarëve dhe Policisë. Kjo qasje aplikohet me qëllim të ngritjes së cilësisë së jetës dhe sigurisë për bashkësinë përmes bashkëpunimit të ndërsjellë në zgjidhjen dhe parandalimin e dukurive negative dhe krimeve të llojeve të ndryshme që potencialisht mund të ndodhin në bashkësi.

Policia e Kosovës është themeluar në vitin 1999 si shërbim policor demokratik, për të garantuar rendin dhe sigurinë publike, të mbrojtë jetën dhe pasurinë e qytetarëve, të garantojë qarkullimin e lirë të njerëzve dhe mallrave, luftimin e informalitetit si dhe të respektojë dhe të mbrojtë të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara në legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe konventat ndërkombëtare.

Në periudhën e administrimit të Misionit të përkohshëm të Kombeve të Bashkuara me Policinë e Kosovës ka funksionuar kryesisht qasja reaktive, ndërsa qasja policore me karakter preventiv e kryesisht ka operuar me të ashtuquajturat ‘zyrat e komunitetit’ në të gjitha nivelet e organizatës. Kjo qasje ka qenë mjaft e kufizuar ngase kanë qenë të angazhuar një numër i kufizuar i zyrtarëve policorë. Me kalimin e kohës është vlerësuar nevoja e përfshirjes së të gjithë zyrtarëve policorë në qasjen preventive të veprimeve policore. Me qëllim të avancimit të kësaj qasjeje, diku në fillim të vitit 2010 hartohet Metodologjia e re e punës policore me orientim të aktiviteteve policore në bashkësi. Kjo metodologji e re e punës policore fillimisht futet në zbatim si pilot projekt në disa stacione policore për të parë vlerësimet brenda organizatës policore, por edhe vlerësimet dhe reagimet e anëtarëve të bashkësisë karshi kësaj qasjeje.

Pas suksesit të pilotimit të metodologjisë së re të punës policore dhe të gjeturave se një qasje e tillë policore është më se e nevojshme dhe bazuar në Strategjinë Nacionale për Siguri në Bashkësi 2011-2016, me vendim të drejtorit të Përgjithshëm të PK-së hartohet Strategjia dhe Plani i Veprimit “Policimi në Bashkësi” 2012-2016. Strategjia në fjalë përmbante tri objektiva kryesore përmes të cilave është shtrirë kjo filozofi apo koncept i policimit në bashkësi siç janë: **1. Transformimi organizativ; 2. Ndërtimi i partneritetit me bashkësinë; dhe 3. Zgjidhje e problemit.**

Policia e Kosovës zbaton edhe konceptin e Policimit të Udhëhequr nga Inteligjenca gjë që mundëson që përmes kontributeve nga policimi në bashkësi të prodhojë produkte analitike, përmes të cilave, në mënyrë efektive dhe efikase drejtohen resurset në adresimin e prioritetet policore, në theks veçantë në: (a) Targetimin e shkelësve, veçanërisht kriminelëve aktivë; (b) Menaxhimin e krimit dhe vendeve të çrregulluara, (c) Hetimin e krimeve dhe incidenteve të ndërlidhura, si dhe (d) zbatimin e masave parandaluese, duke përfshirë edhe bashkëpunimin dhe partneritetin lokal për të zvogëluar krimin dhe çrregullimet tjera.

Zbatimi i kësaj strategjie është përcjellë me ndryshime të strukturës organizative të PK-së, hartim dhe plotësim të shumë procedurave standarde të operimit, udhëzimeve administrative të cilat e kanë avancuar dhe njëkohësisht kanë lehtësuar zbatimin praktik të konceptit të Policimit në bashkësi.

Puna policore e orientuar në bashkësi apo koncepti i policimit në bashkësi pasqyron rolin, rëndësinë dhe ndihmesën e çmuar të bashkësisë dhe partnerëve që së bashku me organizatën për zbatimin e ligjit të ofrojnë siguri të qëndrueshme për bashkësinë. Kjo nënkupton se veprimet dhe aktivitetet policore nuk do të mund të garantojnë efikasitet pa një bashkëpunim të sinqertë me bashkësinë.

Përmes kësaj qasje të policimit, angazhimi gjithëpërfshirës dhe në partneritet me qytetarët do të arrihet të ofrohet ambient i sigurt për bashkësinë. Kjo qasje bashkëpunuese kontribuon në ngritjen e besimit të ndërsjellë në mes të Policisë dhe anëtarëve të bashkësisë.

METODOLOGJIA

Hartimi i kësaj strategjie është bërë përmes një procesi gjithëpërfshirës konsultativ të akterëve të drejtpërdrejtë përgjegjës për zbatimin e suksesshëm të kësaj strategjie, duke përfshirë pjesëtarët e Policisë së Kosovës nga niveli lokal dhe qendror, përfaqësuesit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, përfaqësuesit e forumeve të sigurisë, organizatave joqeveritare, si dhe përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë.

Gjatë hartimit të kësaj strategjie janë shqyrtuar në mënyrë të detajuar të gjitha raportet vlerësuese dhe dokumentet tjera lidhur me zbatimin e Policimit në bashkësi në Kosovë, duke filluar nga ato të përpiluara nga Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës, organizatat joqeveritare dhe raporte vlerësuese të përpiluara nga autoritetet e ndryshme ndërkombëtare. Raportet në fjalë kanë qenë të hartuara në përputhje me qasjen kualitative dhe kuantitative në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, duke filluar me të dhënat e mbledhura nga:

- (a) vrojtimi i vetë procesit të zbatimit të policimit në bashkësi,
- (b) intervistat me pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë të përfshirë në zbatimin e kësaj qasje të policimit,
- (c) grupet e caktuara gjatë ngjarjeve të ndryshme të organizuara për këtë qëllim, siç janë seminare, konferenca, debate, takime;
- (d) sondazhet e ndryshme; si dhe
- (e) të dhënat e krahasuara mbi arritjet dhe sfidat e zbatimit të qasjes së policimit në bashkësi ndërmjet sektorëve policorë/zonave të përgjegjësisë së stacioneve policore.

Si rezultat i këtij procesi të analizës gjithëpërfshirëse lidhur me implementimin e policimit në bashkësi, janë identifikuar me kujdes jo vetëm të gjitha arritjet, por njëkohësisht edhe çështjet që kërkojnë rishikim dhe orientim të ri për periudhën 2017-2021.

Vlen të theksohet që në kuadër të procesit të hartimit të strategjisë janë mbajtur gjithsej 14 takime të grupit punues për hartimin e Strategjisë së Policimit në Bashkësi dhe Planit të Veprimit 2017-2021, proces të cilit i ka paraprirë një agjendë e hartuar nga grupi punues.

Sipas agjendës janë zhvilluar takime me një gjithëpërfshirje të përfaqësuesve të autoriteteve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, si dhe një punëtori gjithëpërfshirëse treditore prej 45 përfaqësuesve ku është shqyrtuar me kujdes i tërë procesi i hartimit të kësaj strategjie. Pas përfundimit të kësaj punëtorie është finalizuar strategjia përkatëse, duke siguruar se çdo veprim i saj është në përputhje me kornizën ligjore dhe aktet nënligjore të cilat rregullojnë çështjet relevante të Policimit në bashkësi, si dhe Planit Zhvillimor Strategjik 2016-2020 të Policisë së Kosovës.

Institucionet e përfshira në grupet e punës:

- Ministria e Punëve të Brendshme;
- Policia e Kosovës;
- Inspektorati Policor i Kosovës.

Organizatat ndërkombëtare, OJQ-të dhe autoritetet tjera të cilët kanë ndihmuar në hartimin e këtij dokumenti për draftin final:

- Programi ICITAP i Departamentit të Drejtësisë së SHBA-së;
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian -Misioni në Kosovë;
- UNDP/FERM- Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara – Programi FERM;
- QKSS- Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë;
- Forumet e sigurisë në bashkësi.

Policia e Kosovës është mirënjohëse dhe falënderuese ndaj të gjithë akterëve të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në hartimin e kësaj strategjie, duke ndihmuar Policinë e Kosovës që së bashku me institucionet përkatëse të nivelit qendror dhe lokal, të fuqizojë qasjen e Policimit në bashkësi, si një ndër parakushtet kryesore për ofrimin e qëndrueshëm të sigurisë në bashkësi.

KORNIZA LIGJORE

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës;
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës;
- Kodi Penal për të Mitur;
- Ligji i Policisë;
- Ligji për barazi gjinore;
- Ligji i Inspektoratit Policor të Kosovës;
- Ligji mbi Rendin dhe Qetësinë Publike;
- Ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje;
- Ligji për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufijve shtetërorë;
- Ligji për të huajt;
- Ligji për rregullat e trafikut rrugor 05-L-088;
- Ligji për gjuetinë – 02-L-53;
- Ligji për vetëqeverisje lokale.

NDËRLIDHJA ME DOKUMENTET STRATEGJIKE:

- Plani zhvillimor strategjik 2016-2020
- Strategjia dhe Plani i Veprimit 2012-2016 “Policimi në Bashkësi”;
- Strategjia Nacionale për Siguri në Bashkësi 2017-2021 (draft);
- Strategjia dhe Plani i Veprimit “Policimi i Udhëhequr nga Inteligjenca” 2013;
- Strategjia Shtetërore dhe Plani i Veprimit i Republikës së Kosovës për Parandalimin e Krimit;
- Strategjia dhe Plani i Veprimit e rishikuar për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar;
- Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit i Republikës së Kosovës për Migracion;
- Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës kundër Krimit të Organizuar dhe Plani i Veprimit;
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës kundër Drogave dhe Plani i Veprimit;
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit;
- Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në terrorizëm;
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe Plani i Veprimit;
- Strategjia dhe Plani i Veprimit Kombëtar i Republikës së Kosovës për Kontrollin dhe Grumbullimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta si dhe Plani i Reagimit Kombëtar dhe Veprimet policore dhe zgjidhja e problemeve me orientim në bashkësi (doracak pune);

AKTET NËNLIGJORE DHE DOKUMENTET TJERA:

- Udhëzimi administrativ 10/2012 bashkëpunimi policor me kuvendin komunal dhe komunitetin

- Udhëzimi administrativ UA MPB 08/2012 - UA /MAP 02/2012, për këshillat komunale për siguri në bashkësi;
- Raporti i IPK-së nr. 8/2015 “Vlerësimi i zbatimit të planit të veprimit të strategjisë për Policimin në bashkësi 2012-2016”,
- Procedura standarde operuese për veprimet policore në sektor;
- Termat e referencës dhe PSO për KLSP.

GJENDJA AKTUALE DHE PERSPEKTIVA

Grupi për monitorim dhe zbatim¹ ka vlerësuar se objektivat dhe aktivitetet që burojnë nga Strategjia dhe Plan i Veprimit 2012-2016 i Policimit në Bashkësi janë përmbushur në pjesën dërmuese. Vlerësimi mbështetet në referencat e raporteve periodike të stacioneve policore, DRP-ve, departamenteve të PK-së, raporti vlerësues i Inspektoratit Policor i vitit 2015, si dhe nga raportet dhe vlerësimet e dala nga takimet dhe punëtoritë e organizuara me qytetarë e sforcjnë këtë vlerësim.

1. Të gjeturat lidhur me arritjen e synimit të parë strategjik (Transformimi organizativ) tregojnë se pjesa dërmuese e aktiviteteve të këtij objekti janë përmbushur. Nga njëzetë (20) detyra të parapara me planin e veprimit, 18 prej tyre janë përmbushur plotësisht, një (1) nuk është trajtuar fare² dhe një (1) tjetër është trajtuar jo kënaqshëm³.

Detyra të përmbushura konsiderohen ato që lidhen me fushat si në vazhdim: emërimi i akterëve në realizimin dhe monitorimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit, nxjerrja e rregullativës ligjore/organizative e që konsiston në hartimin dhe përshtatjen e katërmëdhjetë (14) PSO-ve të reja, përgatitjen dhe përshtatjen e të gjitha moduleve të trajnimit në përputhshmëri me kërkesat e konceptit të policimit në bashkësi, ndarjen e zonave të përgjegjësisë të stacioneve policore. Zonat e stacioneve policore janë ndarë në njëqind e dyzet e katër (144) sektorë patrullues. Janë realizuar trajnimet e nevojshme për gjithë personelin e PK-së në fushën e policimit në bashkësi, përfshirë edhe trajnimet për trajner të Policimit në bashkësi, po ashtu janë mbajtur trajnime për anëtarët e forumeve të sigurisë.

2. Të gjeturat lidhur me arritjen e synimit të II-të strategjik - *Policia e orientuar kah partneriteti* tregojnë se janë përmbushur aktivitetet si në vijim;

- o Identifikimi i partnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë në mbështetje të jetësimit të Strategjisë dhe PV-së, në numrin e forumeve të sigurisë
- o Themelimi dhe funksionalizimi e pesëdhjetë e gjashtë (56) KLSP-ve, tridhjetë e pesë (35) EVSB-ve, si dhe tridhjetë e katër (34) KKS-ve,

¹ Grup i caktuar për monitorimin dhe zbatimin e strategjisë së policimit në bashkësi 2012-2016.

² Muzeu i Policisë në mungesë të mjeteve financiare dhe logjistike nuk është trajtuar fare.

³ Raporti vlerësues i Inspektoratit Policor të Kosovës mbi zbatimin e strategjisë së policimit në bashkësi

- Takimet dhe punëtoritë me partnerë, takimet me qytetarë në promovimin e konceptit të Policimit në bashkësi,
- Projektet e realizuara në përmirësimin e sigurisë në bashkësi, përmes vullnetarizmit qytetar dhe grupeve të përfshira në iniciativa për të ndihmuar PK-në,
- Realizimi i ligjëratave mbi dukuritë negative,
- Informimi i qytetarëve mbi mekanizmat e ankesave, adresimi i tyre në institucionet relevante, statusi i rasteve të raportuara, njoftimi i qytetarëve lidhur me portën e hapur, raportet e forumeve të sigurisë dhe takimeve me bashkësinë në identifikimin e zyrtarëve policorë dhe ndarjen e roleve dhe përgjegjësi të tyre.
- Janë krijuar dosjet sektoriale në të gjitha stacionet policore dhe ato azhurnohen sipas nevojës.
- Ka vazhduar organizimi i takimeve të rregullta të këshillave ekzekutive të KLSP-ve.
- Bazat e të dhënave mbi themelimin e KLSP-ve janë krijuar nga stacionet policore, respektivisht në sektorët policorë.

Të gjitha këto aktivitete kanë shënuar ngritje nga viti në vit, si në sasi ashtu edhe në cilësi, gjë që rezulton në përmbushje të këtij objekti në tërësi.

3. Të gjeturat lidhur me arritjen e synimit të III-të strategjik - *Zgjidhja e problemit.*



- Ka shënuar ngritje numri i OJQ-ve dhe forumeve të sigurisë të përfshira në zgjidhjen e problemeve të bashkësisë në partneritet me Policinë e Kosovës.
- Kanë shënuar ngritje të konsiderueshme projektet e realizuara në bashkësi e që janë kryesisht iniciativa të KLSP-ve të bazuara në kërkesat e bashkësisë,
- Raportet policore mbi shqetësimet dhe brengat e qytetarëve, janë adresuar dhe kanë dhënë rezultate konkrete në zgjidhjen e problemeve,
- Planifikimi dhe drejtimi i patrullimeve policore në sektorë ka dhënë rezultate si në parandalim ashtu edhe në zgjidhjen e problemit,
- Numri në rritje i rasteve të referuara në prokurori dhe gjykata është tregues i qartë i rritjes së efikasitetit të punës policore të bazuar në qasjen e Policimit në bashkësi.

4. Të gjeturat lidhur me Monitorimin dhe Vlerësimin e Realizimi të Planit dhe Strategjisë, tregojnë se Strategjia dhe Plani i Veprimit janë sfiduar nga një numër faktorësh objektivë dhe subjektivë, që kanë paraqitur vështirësi dhe pengesa drejt realizimit të synimeve strategjike. Faktorët e tillë kanë qenë të natyrës: organizative, tekniko-logjistike dhe të partneritetit.

- *Organizative:* mungesa e personelit të nevojshëm për punë sektoriale, angazhimi i kapaciteteve të burimeve ekzistuese në aktivitete jopolicore, transferët e policëve nga sektorët në njësi tjera, mosha e shtyrë e një numri zyrtarësh të angazhuar në sektorë.
- *teknike-logjistike* - mungesa e konsiderueshme e pajisjeve teknike dhe automjeteve, mungesa e hapësirave për punë në disa objekte policore dhe për punë në terren, mungesa e një buxheti për të ndihmuar PK-në dhe Forumet e Sigurisë (KLSP-të) në mbajtjen e takimeve, punëtorive debateve dhe projekteve që kanë të bëjnë me sensibilizimin dhe vetëdijësimin e

bashkësisë për parandalim të krimit dhe zgjidhjes së problemeve që kanë të bëjnë me krimin.


- *të partneritetit* – partneriteti me autoritetet e qeverisjes lokale ka qenë i kënaqshëm, mirëpo duhet të gjenden forma dhe mekanizma për avancimin dhe zgjerimin e partneritetit në të ardhmen.
- Mbi të gjeturat e prezantuara flasin raportet nga stacionet policore, DRP-të dhe njësitë tjera që e kanë zbatuar këtë strategji dhe plan të veprimit siç janë; raporti i inspektimit nr. 8/2015 “Vlerësimi i zbatimit të planit të veprimit të strategjisë për Policimin në bashkësi 2012-2016”, raportet, debatet dhe punëtoritë me dhe nga partnerët strategjikë, siç janë OSBE-ja, ICITAP-i, UNDP-ja e që vlerësojnë pozitivisht arritjet në zbatimin e planit të veprimit të kësaj strategjie.
- Të arriturat dhe rezultatet e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Policim në Bashkësi 2012-2016 i argumentojnë edhe statistikave vjetore të raportimit të rasteve në Policinë e Kosovës që nga viti 2012 kur ka filluar së zbatuari Strategjia dhe PV deri në vitin 2015, me ç’rast shënohet rënie e numrit të rasteve.



Siguria në institucionet e arsimit para-universitar

Ngritja e sigurisë në institucionet para-universitare mbetet një sfidë jo vetëm për Republikën e Kosovës, por edhe rajonin dhe më gjerë. Angazhimi në parandalimin dhe identifikimin e hershëm të problemeve në shkolla mbetet një ndër prioritetet e Policisë së Kosovës. Kjo është arritur përmes një bashkëpunimi të sinqertë dhe reciprok në mes të Policisë, prindërve dhe personelit arsimor.

Edhe pse statistikatat tregojnë një ulje të rasteve të dhunës në dhe përreth shkollave për vitin 2016 në krahasim me atë të vitit të kaluar, nevoja për të avancuar këtë qasje pro-aktive vazhdon të paraqitet si e domosdoshme.



Siguria në komunikacionin rrugor

Prioritet tjetër i Policisë së Kosovës mbetet edhe ngritja e sigurisë në komunikacionin rrugor. Nevoja për përmirësimin e kësaj fushe nuk varet vetëm nga Policia, mirëpo rol të rëndësishëm në këtë drejtim luajnë edhe akterë të ndryshëm në nivel qendror dhe lokal si dhe kontribut të çmuar japin edhe ngasësit e veturave dhe shoqëria në përgjithësi. Statistikat e Policisë së Kosovës tregojnë që për periudhën janar-tetor 2016 kemi një ngritje të rasteve për 8.13%. Gjithsej në këtë vit kemi 14485 aksidente, prej tyre 82 aksidente kanë rezultuar me fatalitet për 92 persona, aksidente me lëndime kanë qenë 5231 me gjithsej 10252 persona të lënduar dhe aksidente me dëme materiale kanë qenë 10349.

Krahasimi i aksidenteve në Kosovë për Janar-Tetor 2015/2016					
Janar-Tetor 2015		Janar-Tetor 2016		(+/-)	%
Aksidente fatale	96	Aksidente fatale	82	-14	-14.58
Persona të vdekur	108	Persona të vdekur	92	-16	-14.81
Aksidente me lëndime	4318	Aksidente me lëndime	5231	913	21.14
Personat e lënduar	8729	Personat e lënduar	10252	1523	17.45
Aksidente me dëme	9107	Aksidente me dëme	10349	1242	13.64
Godit dhe ik	964	Godit dhe ik		/	/
Total aksidente	14485	Total aksidente	15662	1177	8.13
Tiketa të shqiptuara	260527	Tiketa të shqiptuara	276453	15926	6.11

Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm

Dukuria e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që potencialisht shpie në terrorizëm tashmë është bërë fenomen shqetësues në mbarë botën. Republika e Kosovës sikurse edhe vendet e tjera demokratike ballafaqohet me kërcënime të vazhdueshme nga radikalizmi dhe ekstremizmi që mund të qojnë në përdorim të dhunës. Në këtë kuadër institucionet e Republikës së Kosovës janë të përkushtuara në përmbushjen e detyrave që dalin nga baza ligjore dhe strategjitë kombëtare në parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të radikalizmit dhe ekstremizmit me bazë fetare, politike dhe nacionale, ngritjen e kapaciteteve vendore për t'iu kundërvënë këtij kërcënimi si dhe për të qenë partner i rëndësishëm ndërkombëtar në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit. Qytetarët e Republikës së Kosovës janë të përkushtuar për integritet evropian dhe të ardhmen e vet e shohin në kuadër të integriteteve brenda BE-së dhe se radikalizmi dhe ekstremizmi i çfarëdo lloji nuk gëzon mbështetjen e shumicës dërmuese të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Duhet vlerësuar se populli i Kosovës ka ruajtur një tolerancë fetare përgjatë shekujve. Një tolerancë e tillë në veçanti ekziston në mes të kombit shqiptar i cili u përket të tri besimeve më të mëdha: myslimane, katolike dhe ortodokse. Duhet theksuar realitetin se identifikimi i qytetarëve të kombit shqiptar me besimin fetar nuk përkon në domenin e identitetit por është shtresim kulturor. Edhe hulumtimet e fundit nga organizata ndërkombëtare të kryera gjatë vitit 2011 dhe 2012, mbështesin konstatimin se në Kosovë ka një tolerancë të lartë fetare.⁴ Këto hulumtime po ashtu konfirmojnë imazhin popullor të kosovarëve si përkrahës të vlerave pro-perëndimore.

Siguria e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare në Republikën e Kosovës

Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe fetare në Kosovë është shumë i rëndësishëm në paraqitjen e vlerave dhe kulturave të nacionaliteteve që jetojnë në Kosovë. Pikërisht për këtë qëllim në kuadër të Policisë së Kosovës, në vitin 2013 është krijuar Njësia për Mbrojtjen e Objekteve të Trashëgimisë Kulturore dhe Fetare. Përmes aktiviteteve të ndryshme të kësaj njësie dhe në bashkërendim me Drejtorinë e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë synohet që të përmirësohet perceptimi rreth trashëgimisë kulturore dhe fetare dhe të kuptohet si një vlerë e përbashkët nacionale.

⁴ Qendra e Hulumtimit Pew, Muslimanët e Botës: Feja, Politika dhe Shoqëria, 2013, fq.150, 153.

Perspektiva

Të vazhdohet më fuqishëm në gjetjen e alternativave për të tejkaluar vështirësitë dhe sfidat, të cilat kanë qenë pengesë në arritjen e rezultateve maksimale dhe të dëshiruara të cilat derivojnë nga objektivat dhe aktivitetet e Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2012-2016.

- Të ofrojmë shërbime cilësore dhe me prioritet, të përqendruara në zgjidhje të problemeve, brengave dhe shqetësimeve të bashkësisë.
- Organizata policore në të gjitha nivelet duhet të ofrojë mbështetje me qëllim të zbatimit të filozofisë së Policimit në bashkësi.
- Policia e Kosovës duhet ta përshtatë strukturën organizative dhe të sigurojë burime njerëzore të mjaftueshme për zbatimin e kësaj strategjie.
- Burimet materiale janë të domosdoshme dhe duhet të sigurohen për zbatimin e kësaj strategjie.
- Të shfrytëzojmë grupet dhe individët me ndikim dhe funksione specifike në mbështetje të bashkësisë, siç janë anëtarët e forumeve të sigurisë, me qëllim të zgjidhjes së problemeve, brengave dhe shqetësime të bashkësisë e që ndërlidhen me sigurinë, rendin dhe ligjin.
- Të sigurojmë transparencë dhe llogaridhënie përmes udhëheqjes efektive dhe efikase policore në trajtimin profesional, etik dhe moral të kërkesave të qytetarëve karshi PK-së.
- Të mbetet prioritet i PK-së, identifikimi, evidentimi, trajtimi dhe gjetja e zgjidhjeve për kërkesat e adresuara të qytetarëve me synim të eliminimit të faktorëve që kontribuojnë në krim dhe pasiguri për individin dhe bashkësinë, siç janë brenga dhe shqetësimet ndaj krimit, zbulimit të veprave penale dhe kryesve të tyre, si dhe sjellja e tyre para drejtësisë.
- Të bëhet me prioritet identifikimi dhe mbrojtja e individëve dhe grupeve të cënueshme.

VISIONI, MISIONI DHE PARIMET E STRATEGJISË SË POLICIMIT NË BASHKËSI

Vizioni

Policia e Kosovës synon të jetë polici efektive, efikase dhe e besueshme, të ofrojë shërbim cilësor për të garantuar një mjedis të sigurt përmes partneritetit të qëndrueshëm me qytetarin dhe bashkësinë.

Misioni

Misioni i kësaj strategjie do të jetë përfshirja e qytetarit, bashkësisë në të gjitha nivelet e zgjidhjes së problemeve që ndërlidhen drejtpërdrejt apo tërthorazi me sigurinë e bashkësisë dhe ofrimi i një shërbimi më cilësor për viktimat e krimit, duke përmirësuar shkallën e kënaqshmërisë dhe rritjen e besueshmërisë së publikut.

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Strategjia përmes objektivave dhe aktiviteteve do të vazhdojë zbatimin e mëtejshëm praktik të konceptit dhe të filozofisë së Policimit në bashkësi dhe të sigurojë qasje pro-aktive të Policisë karshi problemeve në bashkësi.

Objektivat e kësaj strategjie janë:

I. FUQIZIMI DHE AVANCIMI I PARTNERITETIT

Përmes këtij objektivi synohet vazhdimi i avancimit të partneritetit të Policisë së Kosovës me institucione tjera, me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve dhe këmbimit të informacioneve relevante për parandalimin dhe luftimin e krimit. Në këtë drejtim PK-ja në veçanti përmes këtij objektivi synon të avancojë bashkëpunimin me forume të sigurisë, mediat dhe OJQ-të në nivel lokal, vendor dhe ndërkombëtar, me qëllim të trajtimit të shkaqeve dhe rrethanave të paraqitjes së krimit, e që ndërlidhen me ngritjen e nivelit të sigurisë në përgjithësi.

Policia e Kosovës do të angazhohet në partneritet me institucionet e tjera në të gjitha rastet ku do të mund të cenohej siguria e përgjithshme e qytetarëve si dhe pronës dhe objekteve të rëndësishme të veçantë, veçanërisht atyre të trashëgimisë kulturore dhe fetare.

II. NGRITJA E BESUESHMËRISË DHE KËNAQSHMËRISË SË PUBLIKUT ME PUNËN POLICORE

Ky objektiv me nën objektivat kanë për qëllim ngritjen e cilësisë së shërbimeve policore, gjë që ndikon në ngritjen e nivelit të besueshmërisë dhe kënaqshmërisë së qytetarëve me punën policore.

Përmes këtij objekti, PK-ja synon ofrimin e shërbimeve profesionale, efikase dhe efektive, si dhe ngritjen e nivelit të llogaridhënies tek qytetarët dhe institucionet.

III. BASHKËRENDIMI I AKTIVITETEVE TË POLICIMIT NË BASHKËSI ME STRATEGJITË E TJERA

Strategjia synon që përmes zbatimit praktik të këtij objekti dhe nën objektive të zbërthejë në detyra konkrete të gjitha obligimet që dalin për Policinë e Kosovës nga strategjitë tjera e që ndërlidhen me aktivitetet e Policimit në bashkësi.

IV. AVANCIMI I REFORMAVE TË BRENDSHME DHE MEKANIZMAT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Ky objektiv synon planifikimin për përshtatjen e reformave të brendshme dhe mekanizmave për monitorim dhe zbatim të strategjisë për Policimin në bashkësi, në nivel qendror dhe lokal. Kjo me qëllim që të sigurojë që të gjitha objektivat dhe aktivitetet e parapara me këtë strategji të zbatohen me efikasitet sipas dinamikës së paraparë me këtë dokument.

FUSHAT E VLERËSIMIT RRETH TË ARRITURAVE TË STRATEGJISË SË POLICIMIT NË BASHKËSI

Policimi në bashkësi është proces afatgjatë që kërkon të vlerësohen fusha të caktuara të kësaj strategjie në periudha kohore gjashtë mujore dhe vjetore, në përputhshmëri me PV të kësaj strategjie.

Vlerësimi do të përfshijë këto elemente (fusha të aplikimit):

1. Nivelin e fuqizimit dhe avancimit të bashkëpunimit me komunitetin në zbatim të identifikimit dhe zgjidhjes së problemeve që ndërlidhen me krimin dhe frikën nga krimi në bashkësi.
2. Nivelin e ngritjes së performancës rreth kënaqshmërisë dhe besueshmërisë së bashkësisë karshi shërbimeve që ofron PK-ja në të gjitha nivelet për qytetarët dhe institucionet e Republikës së Kosovës.
3. Shkalla e përmbushjes së aktiviteteve që dalin nga ndërlidhja e strategjive tjera me Strategjinë e Policimit dhe Planit të Veprimit 2017-2021.
4. Avancimi i reformave të brendshme dhe mekanizmat për vlerësim të strategjisë duhet të fuqizohen dhe avancohen krahas nevojave që dalin nga raportimet vlerësuese të kësaj strategjie në periudha kohore të identifikimi të sfidave.

Parimet:

Ligjshmëria: veprimet që duhet të ndërmerren në zbatimin e kësaj strategjie duhet të jenë në pajtueshmëri të plotë me kushtetutën, ligjet dhe aktet tjera normative vendore dhe ndërkombëtare të aplikueshme nga Republika e Kosovës.

Koordinimi dhe bashkëpunimi: - Strategjia e Policimit në bashkësi i mundëson Policisë dhe partnerëve të saj të punojnë bashkërisht në identifikimin dhe zgjidhjen e problemit. Po ashtu mundëson krijimin e një ambienti të sigurt për bashkësinë.

Transparenca: angazhim efektiv, komunikim dhe informatë kthyesë për bashkësinë.

Kënaqshmëria dhe besueshmëria: procesi i komunikimit dhe bashkëpunimit me bashkësinë, me ç'rast do t'iu mundësojë

qytetarëve që të kenë zyrtarin e kontaktit (zyrtarin policor).

Policimi i Udhëhequr nga Inteligjenca: Ndërlidhja e PUI-së me PB-në me qëllim të shkëmbimit reciprok të informatave dhe nxjerrjes së produkteve analitike.

Prioriteti: menaxhmenti monitoron dhe vlerëson performancën dhe përkushtimin që Policia u ofron dhe u shërben nevojave të bashkësisë.

Paanshmëria:

Paanshmëria, Policia e Kosovës i trajton të gjithë personat me respekt, pavarësisht rrethanave dhe iu siguron paanësi me veprimet e veta ndaj qytetarëve, duke iu përmbajtur paanshmërisë etnike, gjinore, religjioze dhe racore.

Shumëllojshmëria: Qasje e barabartë ndaj të gjithë qytetarëve të Republikës së

Kosovës dhe më gjerë duke ofruar shërbime cilësore.

Vlerat: Policia e Kosovës veprimet dhe aktivitetet e saj policore do t'i zhvillojë duke respektuar vlerat e bashkësive që jetojnë në Republikën e Kosovës.

SHKURTESAT

MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MAShT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MSH	Ministria e Shëndetësisë
PK	Policia e Kosovës
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DRP	Drejtoria Rajonale Policore
DBNj	Departamenti i Burimeve Njerëzore
DPSCJL	Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore
DO	Departamenti i Operativës
DH	Departamenti i Hetimeve
DK	Departamenti i Kufirit
DRK	Drejtoria Rajonale e Kufirit
DSHM	Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse
DT	Divizioni i Trajnimeve
DPBP	Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë
DIA	Drejtoria për Inteligjencë dhe Analizë
DTIK	Drejtoria e Teknologjisë Informative dhe Komunikimit
DKT	Drejtoria Kundër Terrorizmit
SIPK	Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës
SP	Stacionet Policore
PB	Policimi në Bashkësi
PUI	Policimi i Udhëhequr nga Inteligjenca
ZIMP	Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun
NjI	Njësia e Inspektimit
NjSOTKF	Njësia për Sigurimin e Objekteve të Trashëgimisë Kulturore dhe Fetare
NjRKRr	Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugorë
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
KOK	Komiteti Olimpik i Kosovës
ICITAP	Programi ndërkombëtar i Asistencës për Trajnime në hetime penale
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
EULEX	Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNICEF	Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
KLSP	Komiteti Lokal për Siguri Publike
EVSB	Ekipi Veprues për Siguri në Bashkësi
EDhRShT	Ekstremizmi i Dhunshëm dhe Radikalizmi që shprien në Terrorizëm
OJQ	Organizata joqeveritare

PËRKUFIZIMET

BASHKËSIA – një grup etnik, fetar, gjuhësor, social, profesional, apo grupe tjera që kanë karakteristika apo interesa të përbashkëta, perceptohen apo perceptojnë veten si të dallueshëm në një mënyrë në shoqërinë brenda së cilës ata ekzistojnë.

SIGURIA NË BASHKËSI – nënkupton, por nuk kufizohet në një koncept që vështrohet paraqitjen e ndryshimeve fizike dhe sociale në përputhje me prioritetet e bashkësive në mjediset lokale si një mënyrë për parandalimin e krimit dhe çrregullimeve tjera. Kjo iu lejon qytetarëve të përcjellin dhe të marrin përfitime të plota nga jeta e tyre sociale dhe ekonomike pa frikë nga krimi, çrregullimet dhe fatkeqësitë.

SIGURIA PUBLIKE nënkupton parandalimin dhe mbrojtjen nga ngjarjet që mund të kërcënojnë sigurinë e publikut të përgjithshëm nga rreziku i konsiderueshëm, të tillë si krimi dhe fatkeqësitë, të dyja natyrore dhe atë të shkaktuar nga njeriu.

POLICIMI NË BASHKËSI - nënkuptojmë një filozofi dhe strategji të organizimit (mënyrë e realizimit të filozofisë) që promovon veprime të bazuara në partneritet dhe bashkëpunim ndërmjet Policisë dhe komunitetit, me qëllim të arritjes së efektivitetit dhe efikasitetit në identifikimin, parandalimin dhe zgjidhjen e problemeve nga kriminaliteti dhe dukuritë negative, për të përmirësuar cilësinë e jetesës për të gjithë.

POLICIMI I UDHËHEQUR NGA INTELIGJENCA – (e njohur gjithashtu edhe si vendimarrja e bazuar në analizat) nënkupton filozofinë e menaxhimit dhe modelin e punës, qëllimi i së cilës është që të arrihet parandalimi, zbulimi dhe zvogëlimi i krimit, duke shfrytëzuar produktet analitike që në mënyrë efektive dhe efikase drejtohen resurset policore në adresimin e prioritet policore, në theks të veçantë: (a) Targetimi i shkelësve, veçanërisht kriminelëve aktivë; (b) Menaxhimi i krimit dhe vendeve të çrregulluara, (c) Hetimi i krimeve dhe incidenteve të ndërlikdhura, si dhe (d) Zbatimi i masave parandaluese, duke përfshirë edhe bashkëpunimin dhe partneritetin lokal për të zvogëluar krimin dhe çrregullimet tjera.

EKSTREM, EKSTREMIZMI: mund të përkufizohet vetëm në lidhje me ideologjinë më të gjerë, që vepron p.sh. në kuadër të nacionalizmit ekstrem, ambientalizmit ekstrem, ekstremizmit fetar. Tipari përkufizues i ekstremizmit është refuzimi i një ose më shumë parimesh bazë të ideologjisë së saj kryesore. Një nacionalist i cili i konsideron pjesëtarët e të gjitha kombeve të tjera si inferiorë, ose që refuzon mundësinë e bashkëjetesës, apo beson se të tjerëve duhet t'u mohohen të drejtat, është një nacionalist ekstrem. Një besimtar fetar i cili dënon udhëheqësit ose pjesën më të madhe të anëtarëve të besimit të tij është një ekstremist. Ekstremistët nuk janë medoemos të dhunshëm.

RADIKALIZMI: procesi i miratimit të ideologjive ekstremiste dhe në disa raste shndërrimi në një ekstremist të dhunshëm.

TERRORIZMI: edhe pse terrorizmi ka formulime të ndryshme, ende nuk ekziston ndonjë përkufizim i saktë, preciz dhe unik lidhur me të, mirëpo një ndër përkufizimet mund të themi se është përdorimi i dhunës me qëllim të shkaktimit të terrorit mbi popullsinë civile. Terrorizmi është një lloj i veçantë i ekstremizmit të dhunshëm.

PARTNERITETI MIDIS POLICISË DHE BASHKËSISË – nënkupton bashkëpunimin e ndërsjellë polici-qytetar me qëllim të identifikimit të hershëm të dukurive negative dhe konflikteve në bashkësi dhe bashkërisht të parandalojnë të njëjtat nga të cilat potencialisht mund të kemi pasoja serioze për vetë bashkësinë.

KKSB – nënkupton Këshillin Komunal për Sigurinë në Bashkësi, i themeluar në secilën komunë të Republikës së Kosovës.

KLSP - nënkupton Këshillin Lokal për Siguri Publike, i themeluar nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë, si një organ këshillues, në kuadër të një zone të caktuar në çdo komunë që është në interesin më të mirë për një punë efektive të Policisë në bashkësi;

EVSB - nënkupton Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi, që përbëhen nga zyrtarët komunalë, policia dhe udhëheqësit e bashkësisë. Qëllimi primar i punës së tyre është që të identifikojnë dhe adresojnë çështjet mbi krimin, sigurinë dhe kualitetin jetësor.

OJQ - nënkupton Organizatat joqeveritare të regjistruara në Zyrën për Regjistrim të OJQ-ve, pranë Ministrisë së Administratës Publike të Republikës së Kosovës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate



PLANI I VEPRIMIT

Aktivitetet	Indikatorët e matës	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Afati kohor për realizim	Kosto	Komentet
Objektivi strategjik 1: FUQIZIMI DHE AVANCIMI I PARTNERITETIT						
NËN OBJEKTIVI 1.1. Ngritja e sigurisë në shkolla						
1.1.1 Organizimi i takimeve periodike lidhur me sigurinë në shkolla me: DKA, përfaqësuesit e shkollave, këshillat e prindërve, OJQ-të dhe forumet e sigurisë.	Së paku dy takime brenda vitit në nivel rajonal me përgjegjësitë e shkollave të ciklit para-universitar	Policia e Kosovës, DPBP, DRP-të dhe stacionet policore	MAShT, DKA, shkollat, OJQ-të	Çdo vit shkollor brenda periudhës së zbatimit të strategjisë 2017-2021	E buxhetuar	

1.1.2 Organizimi i ligjëratave, debateve dhe fushatave vetëdijesuese nëpër shkolla lidhur me dukuritë negative	- Numri i ligjëratave - Numri i pjesëmarrësve - Numri i shkollave - Numri i debateve në media, spoteve, punëtorive, seminareve, aktiviteteve sportive, etj.	Policia e Kosovës	DKA, institucionet shkollore, mediat, OJQ-të	Në vazhdimësi	12000 Euro/vit	Hartimi dhe shtypja e materialeve vetëdijesuese dhe rekuizitave
1.1.3 Organizimi i trajnimeve për trajnerë në nivel lokal (DRP dhe SP) për të ligjëruar në shkolla	- Numri i identifikuar dhe trajnuar i trajnerëve - Hartimi i programit për trajnerë	Policia e Kosovës, DRP	Divizioni i trajnimeve/DP BP	Gjashtëmujori i parë 2017	E buxhetuar	
NËNOBJEKTIVI 1.2 Avancimi dhe fuqizimi i partneritetit me forumet e sigorisë, mediat, OJQ-të dhe organizatat e ndryshme që trajtojnë problemet e sigorisë në bashkësi.						
1.2.1 Organizimi i takimeve, tryezave dhe seminareve me KLSP-të	- Numri i raporteve, i tryezave dhe seminareve me KLSP-të;	DPBP dhe partnerët tjerë	Forumet e sigorisë, Komuna, DRP, Divizioni i Trajnimeve, stacionet policore, partnerët tjerë	Në vazhdimësi	E buxhetuar	

1.2.2 Pajisja me kartela identifikuese anëtarët e KLSP-ve si dhe të mbështeten aktivitetet e tyre me logjistikë	- Numri i anëtarëve të KLSP-ve të pajisur me kartelë. - Numri i aktiviteteve dhe projekteve të mbështetura	DPBP, DRP-të, stacionet policore/ sektorët patrullues	DPPK, DShM	Në vazhdimësi	1000/vit	
1.2.3 Themelimi i KLSP-ve, rifreskimi, ngritja e pjesëmarrjes së gruas dhe të rinjve dhe trajnimi i tyre	- Numri i kërkesave për themelim, rifreskim dhe trajnim - Numri i anëtarëve të trajnuar - Përqindja e pjesëmarrjes së gruas dhe të rinjve	DPPK, DPBP, partneret ndërkombëtare	Stacionet policore, DRP-të, partneret ndërkombëtare	Në vazhdimësi	E buxhetuar	
1.2.4 Pjesëmarrja e zyrtarëve policorë në aktivitetet e forumeve të sigurisë, mediat, OJQ-të dhe organizatat e ndryshme që trajtojnë problem të sigurisë në komunitet	- Numri i raporteve zyrtare për pjesëmarrje - Numri i temave, çështjeve dhe kërkesave të trajtuara - Numri i projekteve realizuara.	Stacionet policore /sektorët patrullues	DSP DPBP DRP OSBE	Në vazhdimësi	E buxhetuar	

1.2.6 Organizimi i takimeve me forumet e sigurisë, mediat, OJQ-të dhe organizatat e ndryshme me qëllim të promovimit të strategjisë në bashkësi dhe të arriturve të PK-së.	Së paku dy takime në vit	DRP-të/Zyrat regionale të mediave, ZIMP-PK, stacionet policore dhe DPBP	MPB/DSB, OJQ-të, Mediat e shkruara dhe elektronike, Portalet etj.	Në vazhdimësi	E buxhetuar	
1.2.7 Organizimi i fushatave vetëdijesuese për promovimin e rëndësisë së KLSP-ve	- Numri i fushatave - Numri i broshurave - Numri i prezantimeve në media	DPBP, DRP-të, SP	ZIMP, KLSP-të, partnerët ndërkombëtarë	Në vazhdimësi	E buxhetuar + donacion	
NËNOBJEKTIVI 1.3 Avancimi i partneritetit me komunitetin e biznesit dhe komunitetin kulturor-sportiv						
1.3.1 Organizimi dhe pjesëmarrja në takime me përfaqësues të biznesit lidhur me ngritjen e sigurisë.	Së paku një takim në vit	Policia e Kosovës (DRP-të dhe stacionet policore)	Komuniteti i biznesit, Komunitat	Në vazhdimësi	E buxhetuar	

1.3.2 Realizimi i projekteve të përbashkëta për përmirësimin e mjedisit të sigurisë.	Numri i projekteve të realizuara	Policia e Kosovës (DRP-të dhe stacionet policore)	Komuniteti i biznesit, Komunitat, forumet e sigurisë, OJQ-të	Në vazhdimësi	E buxhetuar/ donacion	
1.3.3 Organizimi dhe pjesëmarrja në takime bashkërenduese me komunitetin sportiv	Së paku dy takime gjatë vitit	Policia e Kosovës (DRP-të dhe stacionet policore)	MKRS, KOK, Drejtoria Komunale për kulturë, rini dhe sport, federatat, klubet sportive, grupet e tifozëve, mediat, menaxheret e objekteve sportive	Në vazhdimësi, sipas kalendarit të ngjarjeve sportive	E buxhetuar	
1.3.4 Organizimi dhe pjesëmarrja në takime bashkërenduese me komunitetin kulturor	Së paku një takim gjatë vitit	Policia e Kosovës (DRP-të dhe stacionet policore)	MKRS, Drejtoria Komunale për kulturë, rini dhe sport,	Në vazhdimësi, sipas kalendarit të ngjarjeve kulturore	E buxhetuar	

NËNOBJEKTIVI 1.4 Ngritja e sigurisë në trafikun rrugor

1.4.1 Organizimi i takimeve koordinuese me partnerë në lidhje me sigurinë në rrugë	Së paku dy takime gjatë vitit	DPP dhe DRP-të	MPB, MI, MASHT, MD, KGJK, MSH, AKK, Këshilli për Siguri në Trafikun Rrugor, BKS dhe Shoqata e Sigurimeve, OJQ	Në vazhdim ësi	E buxhetuar	
1.4.2 Identifikimi i pikave të zeza dhe problemeve në trafik në nivel të DRP-ve	- Numri i raporteve - Numri i pikave të zeza të identifikuara	DPP (Divizioni i Komunikacionit Rrugor), DRP (Njësitë Rajonale të Komunikacionit Rrugor), Stacionet Policore	MPB, MI, MASHT, MD, MF, MSH, AKK, ZKM	Në vazhdim ësi	E buxhetuar	Numri i raporteve me inspektime sipas vendimit nga MI-ja për identifikim të pikave të zeza, që dërgohen te institucionet përkatëse për përmirësimin e tyre
1.4.3 Hartimi i planeve të veprimit dhe realizimi i projekteve nga aktiviteti 1.4.2 dhe fushata vetëdijesuese për siguri në trafik	- Numri i projekteve - Numri i fushatave	DPP (Divizioni i Komunikacionit Rrugor), DRP (Njësitë Rajonale të Komunikacionit Rrugor), Stacionet Policore	MPB, MI, MASHT, MD, MF, MSH, AKK, ZKM, Këshilli për Siguri në Trafikun Rrugor, Byroja Kosovare e Sigurimeve dhe Shoqata e Sigurimeve, OJQ	Në vazhdim ësi	4000 euro/vit dhe donacione nga institucionet përkrahëse	Aktivitete vetëdijesuese për trafik (broshura, fletushka, spote televizive, etj)

1.4.4 Inspektimet periodike të rrugëve	Së paku dy inspektime gjatë vitit në nivel qendror, ndërsa çdo tre muaj në nivel të DRP (raporti dhe rekomandimet)	Divizioni i Komunikacionit Rrugor, DRP-të, NJRKRR, NJKA, Stacionet Policore	MI, Komunitat	Në vazhdimësi	E buxhetuar	
---	--	---	---------------	---------------	-------------	--

NËNOBJEKTIV 1.5 Avancimi i sigurisë së objekteve të trashëgimisë kulturore, fetare dhe objekteve nën mbrojtjen e MKRS-së

1.5.1 Inspektimi i objekteve dhe hartimi i dosjeve të veçanta.	Së paku një raport me rekomandime në vit	NJSOTKF, DRP, Stacionet policore, sektoret policore	MKRS, DRP-të, stacionet policore, sektorët policorë, bashkësitë fetare	Në vazhdimësi	E buxhetuar	
1.5.2 Organizimi i takimeve koordinuese dhe bashkëpunuese me partnerët relevantë	Së paku dy takime gjatë vitit në nivel të DRP-ve	NJSOTKF, DRP Stacionet policore, sektoret policore,	MKRS, DRP-të, stacionet policore, bashkësitë fetare	Në vazhdimësi	E buxhetuar	
1.5.3 Rivlerësimi i kërcënimit dhe ofrimi i sigurisë.	Numri i raporteve vlerësuese	NjVKRR	DIA, DRP, Stacionet policore	Në vazhdimësi	E buxhetuar	

1.5.4 Monitorimi, raportimi dhe adresimi periodik në lidhje me gjendjen e objekteve.	- Së paku 4 raporte periodike.	NJSOTKF	MKRS, DRP-të, stacionet policore, bashkësitë fetare	Në vazhdimësi	E buxhetuar	
---	--------------------------------	---------	---	---------------	-------------	--

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: NGRITJA E BESUESHMËRISË DHE KËNAQSHMËRISË SË PUBLIKUT ME PUNËN POLICORE

NËNOBJEKTIVI 2.1 Trajnimi dhe vetdijësimi i personelit lidhur me qasjen e kënaqshmërinë dhe besueshmërinë e qytetarëve me punën policore

2.1.1 Hartimi i programit të trajnimit për personelit të PK-së	Plani i hartuar dhe aprovuar	Divizioni i trajnimeve	DPBP dhe partnerët	Gjashtëmujori i parë 2017/sipas planit të shtrirjes së strategjisë	E buxhetuar	
2.1.2 Organizimi i punëtorive vetëdijesues për stafin e lartë menaxhues	Së paku një punëtori në secilën DRP dhe një punëtori në DPP	Divizioni i trajnimeve	DPBP dhe partnerët	2017	E buxhetuar	Në punëtori përfshihen edhe përfaqësuesit e DRK-ve
2.1.3 Identifikimi dhe trajnimi i trajnerëve	- Identifikimi i nevojave për trajnerë - Numri i trajnerëve të certifikuar	Divizioni i trajnimeve	DPBP dhe partnerët	Gjashtëmujori i parë 2017/sipas planit të shtrirjes së strategjisë	E buxhetuar	

NËNOBJEKTIVI 2.2. Ndërmarrja e veprimeve për ngritjen e kënaqshmërisë dhe besueshmërisë me punën policore

2.2.1 Realizimi i hulumtimit të opinionit publik lidhur me kënaqshmërinë dhe besueshmërinë	Së paku një hulumtim në vit	DPP, DRP-të, stacionet policore	IPK, partnerët dhe OJQ-të	Në vazhdimësi	10000/vit	
2.2.2 Hartimi i planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve të dala nga hulumtimi	– Së paku një plan në vit – Numri i rekomandimeve të adresuara	DPP, DRP-të, stacionet policore	/	Në vazhdimësi	E buxhetuar	
2.2.3 Krijimi i profilit në ueb faqe për DRP-të, paraqitjet publike dhe publikimi i raporteve periodike për ngritjen e transparencës	Ueb faqja e krijuar dhe numri i raporteve periodike	DPP, DRP-të, DPBP	ZIMP	Gjashtëmujori i parë 2017 (krijimi i ueb faqes) Ne vazhdimësi për pikat tjera	E buxhetuar	
2.2.4 Hartimi i planit të veprimit për shtrirjen e qasjes policore mbi kënaqshmërinë dhe besueshmërinë	Plani i hartuar	DPP, DSP, DPBP	IPK, Divizioni i Trajnimeve, DShM, partnerët ndërkombëtarë	2017	E buxhetuar	

2.2.5 Hartimi i formave unike të pakove të viktimave, aprovimi dhe shpërndarja	Format e hartuara dhe aprovuara	DPSÇL	Partnerët	2017	E buxhetuar/ donacion	
2.2.6 Mbajtja e takimeve periodike me përfaqësuesit e fshatrave dhe bashkësive lokale të zonave urbane	Së paku një takim në vit	DRP, stacionet e rendit dhe të policisë kufitare (vetëm stacionet që janë në brezin kufitar)	Partnerët	Në vazhdimësi	E buxhetuar	
2.2.7 Hartimi dhe rishikimi i procedurave për kohën e reagimit në raste, si dhe krijimi i kapaciteteve	- Procedura e hartuar - Shpejtësia e arritjes - Analiza e raporteve	DPP, DRP-të, stacionet policore	/	Gjashtëmujori i parë 2017	E buxhetuar	
2.2.8 Trajnimi i zyrtarëve policorë/hetuesve bazuar në modelin e kënaqshmërisë dhe besueshmërisë	- Numri i zyrtarëve të trajnuar	DRP, Divizioni i Trajnimeve	/	2017	E buxhetuar	
2.2.9 Caktimi i rasteve me prioritet dhe monitorimi i progresit të hetimeve tek këto raste	- Numri i rasteve me prioritet të zgjidhura, si dhe raportet periodike lidhur me zbulimin e krimit	Shefat e hetimeve të SP dhe shefat e SHR	/	Në vazhdimësi	E buxhetuar	

2.2.10 Organizimi i takimeve në mes të zyrtarëve policorë sektorialë, mbikëqyrësve të sektorit dhe koordinatorët e sektorëve, me qëllim të këmbimit të informacioneve lidhur me situatën e sigurisë dhe krimit në rajonin përgjegjës	Numri i takimeve dhe procesverbalet (së paku çdo tre muaj)	DRP, Stacioni policor	Koordinatori rajonal	Në vazhdimësi	E buxhetuar	
2.2.11 Monitorimi i qasjes së kënaqshmërisë dhe besueshmërisë	Publikimi i raportit monitorues	IPK dhe partnerët	/	Në vazhdimësi	E buxhetuar	

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: BASHKËRENDIMI I AKTIVITETEVE TË POLICIMIT NË BASHKËSI ME STRATEGJITË TJERA

NËNOBJEKTIVI 3.1 Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm

3.1.1 Krijimi dhe mirëmbajtja e dosjeve në sektor në lidhje me personat e dyshimtë që ndërlidhen me ekstremizëm dhe radikalizëm	- Numri i dosjeve të krijuara - Numri i lokacioneve të identifikuara - Numri i raporteve të adresuara	Stacioni policor/sektori policor	DPP, DRP, DKT, DPBP	Krijimi i dosjeve – 2017 Mirëmbajtja - në vazhdimësi	E buxhetuar	
3.1.2 Identifikimi i hershëm i personave, aktiviteteve të dyshimta EDhRT dhe adresimi tek organet kompetente.	- Identifikimi i kriterëve - Numri i personave, aktiviteteve dhe lokacioneve të identifikuara	DKT, Stacioni policor/sektori patrullues	DIA, DKT, Mekanizmi referues	Në vazhdimësi	E buxhetuar	Listën e kriterëve identifikuese të personave dhe aktiviteteve të dyshimta që lidhen me EDhRT e krijon DKT-ja
3.1.3 Organizimi i trajnimeve vetëdijesuese për zyrtarët policorë në lidhje me EDhRT.	- Hartimi i programit - Numri i trajnimeve - Numri i zyrtarëve të trajnuar	Divizioni i trajnimeve dhe DKT,	DRP-të dhe stacionet policore	Hartimi i programit 2017 Trajnimi në vazhdimësi	E buxhetuar	Divizioni i Trajnimit harton një plan të veprimit për organizimin e trajnimeve

3.1.4 Organizimi i ligjëratave vetdijësuese në lidhje me EDhRT në shkollat e ciklit para-universitar.	Numri i ligjëratave, shkollave dhe nxënësve pjesëmarrës	DRP, DKT, stacionet policore	MAShT, DKA, përfaqësuesit e bashkësive fetare në Kosovë, OJQ-të	Në vazhdimësi	E buxhetuar	
NËNOBJEKTIVI 3.2 Bashkërendimi i aktiviteteve me strategjinë e PUI						
3.2.1 Organizimi i takimeve të përbashkëta periodike në nivel lokal dhe qendror, me qëllim të koordinimit në zbatim të strategjive	Së paku dy takime në vit	- Koordinatorët për zbatim të strategjisë (SPB dhe PUI) – niveli qendror, - Drejtori rajonal në nivel lokal	DH, DO, DK, DShM, DBNj, DIA dhe DKT	Në vazhdimësi	E buxhetuar	
3.2.2 Funkcionalizimi i dhomës për regjistrimin e informatave dhe rasteve/instalimi i sistemit dhe trajnimi i stafit	- Numri i dhomave të funksionalizuara - Hartimi i programit për trajnim - Trajnimi i trajnerëve në nivel lokal - Numri i zyrtarëve të trajnuar	DIA dhe DTIK	DO, DT, DShM	Hartimi i programit të trajnimit 2017 Trajnimi i trajnerëve tetor 2017	E buxhetuar	Programi i trajnimit hartohet nga DTIK, DIA dhe DT

3.2.3 Hartimi i raporteve periodike lidhur me grumbullimin e informacioneve	- Numri i raporteve mujore - Numri i informacioneve mujore	DRP, DIA, stacionet policore, SHR, NjRKRR, NjRSh	DIA, SIPK	Në vazhdimësi	E buxhetuar	
3.2.4 Hartimi dhe azhurnimi i hartave kriminale në nivel lokal dhe qendror	- Numri i hartave të krijuara dhe azhurnuara	DRP, stacion/ sektor/ Nj RKRR	DIA, SIPK	Krijimi 2017, azhurnimi në vazhdimësi	E buxhetuar	

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: AVANCIMI I REFORMAVE TË BRENDSHME DHE MEKANIZMAT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË STRATEGJISË

NËNOBJEKTIVI 4.1. Fuqizimi i sektorëve policorë

4.1.1 Rishikimi i sektorëve policorë bazuar në kriteret e themelimit.	- Numri i sektorëve policorë të rishikuar	Komandantët e Stacioneve Policore	DRP-të dhe DPBP-ja	Gjashtë mujori i parë 2017	E buxhetuar	
4.1.2 Zbatimi i standardit të qëndrimit “së paku dy vjet” i zyrtarëve policorë në sektorin policor.	- Raportet vjetore të përmbushjes së këtij standardi	Komandantët e SP-ve dhe DRP-të.	Divizioni për Siguri Publike dhe Departamenti i Operacioneve.	Në vazhdimësi	E buxhetuar	
4.1.3 Hartimi dhe aprovimi i formës mujore unike e evidentimit dhe raportimit të të	- Forma mujore unike e aprovuar, Raportet e bazuara në këtë formë.	Divizioni i Sigurisë Publike	DRP-të, DPBP, DPSÇL dhe stacionet policore.	Aprovimi i formës në gjashtë mujorin e parë 2017 dhe	E buxhetuar	

gjitha aktiviteteteve policore në sektor patrullues.				Raportimet ne baza periodike		
4.1.4 Fuqizimi dhe funksionalizimi i kapaciteteve njerëzore dhe logjistike. (Realizimi i një pilot-projekti i sektorit model në një DRP)	Raportet mbi sektorët e kompletuar me staf dhe logjistikë Realizimi i pilot-projektit	Komandantët e stacioneve policore dhe DRP-të	Departamenti i operacioneve, Departamenti i shërbimeve mbështetëse, Divizioni për Siguri Publike, dhe DRP-të	Në vazhdimësi - Realizimi i pilot-projektit në gjysmën e dytë 2017	E buxhetuar	-Pilot projekti të zbatohet në të gjitha SP të kategorisë A (një sektor) - Raporti përmbledhës mbi të arriturat e pilot-projektit
4.1.5 Vazhdimi i hapjes se zyrave kontaktuese në kuadër të sektorit në zonat rurale	Numri i zyrave të hapura	DRP, Stacionet policore	DShM, komunat	Në vazhdimësi	E buxhetuar	
NËNOBJEKTIVI: 4.2. Rishikimi i procedurave të veprimit						
4.2.1 Rishikimi dhe ndryshimi i të gjitha PSO-ve dhe dokumenteve tjera që ndërlidhen me zbatimin e kësaj strategjie	Numri i procedurave dhe dokumenteve të rishikuara dhe ndryshuara.	Stacionet policore, DRP, DSP, DPBP, etj.	DPSÇL	Në vazhdimësi	E buxhetuar	

NËNOBJEKTIV 4.3 Mekanizmat e përkrahjes, monitorimit, vlerësimit dhe raportimit

4.3.1 Emërimi i koordinatorit dhe grupit për monitorim dhe zbatim në nivel qendror të DPP-së	Vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës	Drejtori i Përgjithshëm	/	Në fillim të 2017	E buxhetuar	
4.3.2 Emërimi i koordinatorit dhe grupit për monitorim dhe zbatim në nivel rajonal të rendit dhe kufirit	Vendimi i Drejtorit Rajonal të rendit publik dhe kufirit	Drejtorët rajonalë	/	Në tremujorin e parë të 2017	E buxhetuar	
4.3.3 Organizimet e takimeve vlerësuese periodike	- Niveli qendror 2 takime në vit - Niveli rajonal 4 takime në vit	Koordinatorët në nivel qendror dhe rajonal	DO, DK, DShM, ZIMP dhe partnerët tjerë	Në vazhdimësi	E buxhetuar	
4.3.4 Inspektimet në terren për zbatim të strategjisë	Së paku një inspektim brenda vitit	Grupi qendror dhe rajonal për zbatim dhe monitorim të strategjisë	IPK, NjI	Në vazhdimësi	E buxhetuar	
4.3.5 Përpilimi i raportit vjetor vlerësues për zbatimin e strategjisë	Raporti i hartuar	Grupi qendror dhe grupi rajonal për zbatim dhe monitorim të strategjisë	/	Në vazhdimësi (muaji janar i çdo vitit)	E buxhetuar	Raport vjetor lidhur me zbatimin e strategjisë i adresohet drejtorit të Përgjithshëm

4.3.6 Rishikimi dhe plotësimi i planit të veprimit	Sipas nevojës	Grupi qendror për zbatim dhe monitorim të strategjisë	Grupet rajonale për zbatim dhe monitorim të strategjisë dhe partnerët	Sipas nevojës	E buxhetuar	Me aprovim të drejtorit të Përgjithshëm
---	---------------	--	---	---------------	----------------	---